



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

**UDHËZIM**

Nr. 04, Datë 31.03.2016

**PËR  
PROCEDURAT DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT  
TË KUOTAVE TË GRADIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, gjermës "f", të pikës 2, të nenit 13 të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

**1. Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktohet mënyra, kriteret dhe procedurat për përcaktimin e kuotave të gradimit të oficerëve dhe nënoficerëve.

**2. Fusha e zbatimit**

Ky udhëzim është i zbatueshëm për përcaktimin e kuotave të gradimeve të oficerëve dhe nënoficerëve. Ai do të zbatohet nga të gjitha strukturat e FA-së që merren me menaxhimin e personelit.

**3. Referencat ligjore**

- Ligji nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Rregullorja e Komisioneve të Karrierës;
- Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2015-2019, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 772, datë 12.05.2015.

**4. Objektivat**

- 4.1. Të përmirësohet dhe standardizohet procedura dhe kriteret e përcaktimit të kuotave të gradimeve për oficerët dhe nënoficerët.

- 4.2. Të përcaktohen kuota sa më reale gradimi, të cilat të mbajnë parasysh nevojat e shërbimeve të FA-së, të specialiteteve ushtarake dhe të vetë ushtarakëve.

## **5. Autoritetet dhe përgjegjësitë**

- 5.1. Autoritetet në fushën e përcaktimit të kuotave të gradimeve janë:

- a) Ministri i Mbrojtjes;
- b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së;
- c) Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse/ Komandat e reparteve autonome;
- d) Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit në MM (DBNJZHP);
- e) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-1);
- f) Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR).

- 5.2. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti për miratimin e kuotave të gradimeve, sipas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Miratimi i kuotave të gradimeve në bazë të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 59/2014, bëhet brenda muajit mars të çdo viti.

- 5.3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së është autoriteti përgjegjës për t'i propozuar Ministrit të Mbrojtjes kuotat e gradimeve. Sipas pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 59/2014, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqet Ministrit të Mbrojtjes nevojat organike të Forcave të Armatosura për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve.

- 5.4. Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse/ Komandat e reparteve autonome përgjigjen për:

- a) Kryerjen e studimeve për një periudhë 5 vjeçare të përdirësuar vit pas viti për përparimin në gradë të personelit;
- b) Planifikimin e nevojave për promovimin e personelit ushtarak. Planifikimi bëhet minimalisht për një periudhë 5 vjeçare i përditësuar vit pas viti;
- c) Përcaktimin e kuotave për gradimin e personelit nënoficer dhe oficer të strukturës së tyre;
- d) Dërgimin e propozimeve për kuotat e gradimeve të shoqëruar me një relacionin shpjegues, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Sipas pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 59/2014 "Komandantët e forcave dhe komandantët e strukturave mbështetëse, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nevojat organike të strukturave që drejtojnë për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve".

- 5.5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit në MM përgjigjet për:

- a) Hartimin e udhëzimeve, kriterëve dhe procedurave për përcaktimin e kuotave të gradimeve;
- b) Kryerjen e studimeve për një periudhë 5 vjeçare të përditësuar vit pas viti dhe propozimin e çështjeve konkrete në lidhje me përcaktimin e kuotave të gradimeve;
- c) Bashkëpunon me J-1 për përcaktimin e kuotave të gradimeve.

- 5.6. Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm ( J-1) përgjigjet për:

- a) Zbatimin e udhëzimeve, kritereve dhe procedurave për përcaktimin e kuotave të gradimeve;
- b) Kryerjen e studimeve për një periudhë 5 vjeçare të përditësuar vit pas viti dhe propozimin e çështje konkrete në lidhje me përcaktimin e kuotave të gradimeve;
- c) Bashkpunon me komandat për përcaktimin e kuotave të gradimeve;
- d) Shqyrton propozimet e komandave;
- e) Përgatit propozimet për kuotat e gradimeve për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

#### 5.7. Qendra e Personel- Rekrutimit përgjigjet për:

- a) Përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të të dhënave të nevojshme për oficerët dhe nënoficerët;
- b) Mbështetjen e J-1 dhe DBNJZHP me të dhëna për përcaktimin e kuotave të gradimeve për oficerët dhe nënoficerët, nëpërmjet kryerjes së studimeve dhe analizave.

### 6. Faktorët që influencojnë përcaktimin kuotave të gradimeve

#### 6.1. Faktorët që influencojnë procesin e përcaktimit të kuotave të gradimeve janë:

- a) Ligji nr. 59/2014, i cili në pikë 6, të nenit 18, përcakton se “Gradimi, bëhet në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- b) Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2016- 2025;
- c) Nevojat organike sipas TOP;
- d) Gjëndja faktike e personelit sipas gradave;
- e) Vendet bosh faktike, të krijuara nga faktorë të ndryshëm;
- f) Vendet bosh që mund të krijohen për shkak të nxjerrjes në rezervë ose në lirim të oficerëve dhe nënoficerëve, në zbatimin të neneve 25 dhe 26 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- g) Vendet bosh që mund të krijohen nga gradimet e mundshme ose që priten të ndodhin për oficerët dhe nënoficerët;
- h) Gjëndja e specialiteteve ushtarake të FA-së;
- i) Sasia dhe cilësia e personelit që plotëson kriteret ligjore për gradim.

6.2. Duke qënë se nevojat për gradimin e oficerëve dhe nënoficerëve nuk janë të njëjta nga njëri vit në tjetrin, për shkak të rekrutimeve dhe nxjerrjes në rezervë ose lirim të ushtarakëve, duhet të mos grupohen në një vit një numër i madh gradimesh dhe vitin tjetër një numër i kufizuar. Ky është një faktor i cili duhet marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të kuotave. Në këtë rast kërkohet një shpërndarje e drejtë e tyre, sipas planifikimit të bërë.

### 7. Procedura për përcaktimin e kuotave të gradimeve

#### 7.1. Për përcaktimin e kuotave të gradimeve zbatohet procedura e mëposhtme:

- a) Kuotat e gradimeve përcaktohen në periudhën 1 shkurt- 31 mars të çdo viti.

- b) Komandat e forcave/komandat mbështetëse, brenda datës 20 shkurt të çdo viti i propozojnë Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nëpërmjet J-1, nevojat që ata kanë për gradimin e oficerëve dhe nënoficerëve.
- c) Brenda datës 15 mars, J-1 në bashkëpunim me DBNJZHP dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim, në bazë të propozimeve të komandave, përgatit propozimet përkatëse për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.
- d) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, jo më vonë se data 20 mars i paraqet Ministrit të Mbrojtjes, propozimet për miratimin e kuotave të gradimeve.
- e) Kuotat e gradimit miratohen nga Ministri brenda muajit mars.

## **8. Metodologjia që ndiqet në përcaktimin e kuotave të gradimeve**

- 8.1. Përcaktimi i kuotave të gradimeve është një veprimtari e planifikuar dhe si e tillë është pjesë e procesit të planifikimit të nevojave të personelit nga ana e strukturave të FA-së.
- 8.2. Drejtoria e Personelit në SHP dhe Seksionet e Personelit në Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse janë strukturat që përgjigjen drejtpërdrejtë për planifikimin dhe përcaktimin e nevojave për gradimin e oficerëve dhe nënoficerëve.
- 8.3. Kuotat e gradimeve do të përcaktohen sipas llojeve të forcave, sipas specialiteteve brenda forcave dhe sipas gradave për të gjitha kategoritë e ushtarakëve.
- 8.4. Për oficerët e gradave të ulëta Toger dhe Kapiten dhe nënoficerët me gradat Tetar dhe Rreshter, kuotat përcaktohen më vete për çdo specialitet ushtarak, brenda secilës nga kategoritë e forcave.
- 8.5. Kategoritë e forcave dhe specialiteteve që përfshihen në to janë:
  - a) Forca Tokësore, KM, KDS, Repartet Autonome, AISM;
    - Këmbësori, zbulim, xhenio, kimi, artileri tokësore, financë, juridik, logjistikë, transport, armatim-municioni, ndërlidhje, IT, etj.
  - b) Forcat Ajrore;
    - Pilot, teknik ajror, kontroll ajror, meteo, etj.
  - c) Forcat Detare;
    - Detar/Marinë, teknik naval, zhytës nënujor, etj.
  - d) Mjekësia dhe orkestra frymore.
- 8.6. Për oficerët e gradave të larta Major, Nënkolonel dhe Kolonel dhe nënoficerët e gradave Kapter dhe Kryekapter, zakonisht kuotat përcaktohen sipas llojeve të forcave, pa specialitete.
- 8.7. Kur është e nevojshme, për specialitete të caktuara, kuotat e gradimeve sipas specialiteteve, mund të përcaktohen edhe për gradën e majorit.

8.8. Kuotat për specialitetin e mjekësisë dhe të orkestrës frymore përcaktohen më vete për të gjitha gradat nga Toger deri tek Kolonel për oficerët dhe nga Tetar deri tek Kryekapter për nënoficerët.

## **9. Radha e punës për përcaktimin e kuotave të gradimeve**

9.1. Për përcaktimin e kuotave të gradimeve zbatohen hapat e mëposhtëm:

- a) Hapi i parë: Përcaktohen nevojat organike, të cilat nxirren nga TOP dhe në përputhje me pikën 8 të këtij udhëzimi. Nevojat organike përfaqësojnë nevojat maksimale për gradim;
- b) Hapi i dytë: Studiohet gjëndja faktike e gradave të personelit oficer dhe nënoficer, nëpërmjet të cilës përcaktohet numri faktik i oficerëve dhe nënoficerëve.
- c) Hapi i tretë: Përcaktohen vendet bosh faktike, të krijuara. Diferenca e nevojave organike me ato faktike do ta japë vendet bosh faktike. Vendet bosh faktike luajnë rolin e kuotave të përafërta për promovim.
- d) Hapi i katërt: Përcaktohen vendet bosh që mund të krijohen në të ardhmen për shkak të nxjerrjes në rezervë ose në lirim të oficerëve dhe nënoficerëve, si rezultat i zbatimit të neneve 25 dhe 26 të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- e) Hapi i pestë: Përcaktohen vendet bosh që mund të krijohen për shkak të gradimeve të mundshme ose që priten të ndodhin për oficerët dhe nëoficerët.
- f) Hapi i gjashtë: Kuotat e gradimeve përcaktohen si diferencë ndërmjet nevojave organike dhe vendeve bosh.

9.2. Për një përcaktim sa më real dhe të studiuar të kuotave është e nevojshme të ballafaqohet personeli faktik, i cili plotëson kriteret e gradimit, me kuotat faktike, në pikpamje sasiore dhe cilësore, për të ruajtur një raport logjik ndërmjet numrit të kandidatëve dhe kuotave. Kjo do të ndihmonte në përcaktimin e kuotave në përputhje me nevojat dhe prespektivën e Forcave të Armatosura.

## **10. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e udhëzimit**

10.1. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, Komandat e Forcave ato mbështetëse e reparteve autonome dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit.

10.2. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjherë.

**MINISTRI**

**MIMI KODHILI**

